

**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MORGAN & CHARLOTTE”**

Ne kete statut

- “Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare”;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;

**Kreu I
THEMELIMI,EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA,SELIA,**

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me date 26/02/2019, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqeri me pergjegjesi, me emrin MORGAN & CHARLOTTE shpk.

Themeluesit e shoqerise jane :

- **Smerald Qamil Bozaxhiu**, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, i dtl.12/03/1989
- **Dorian Bashkim Boja**, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, i dtl.25/04/1989


Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryej aktivitetin :

- *Veprimtari tregetare ne fushen e ushqimit social, bar-buse, restorante, hoteleri dhe aktivitet turistik.*
- *Tregetim te artikujve te ndryshem te konsumit te gjere,industrial e ushqimiore, lende te para, materiale, paisje dhe makineri te llojeve te ndryshme e pjesë kembimi per to, me shumice e pakice, më importe dhe eksporte*
- *Import-eksport dhe tregetim te mjeteve te transportit (automjete, motoçiklete, biciklete, etj.), pjesë kembimi e materiale konsumi per to, te reja e te perdonura.*
- *Veprimtari ne transporte te llojeve te ndryshme te mallrave e udhetareve, me tranzitime ne porte e pika kufitare te Shqiperise.*
- *Grumbullim, perpunim dhe tregetim te produkteve bujaesore, blegtorale, bime medicinale e prodhime te pyllit.*
- *Konsulencje tregetare e marketingu, sherbime te tjera te ngjashme.*
- *Kryerje e transaksioneve te ndryshme te importeve dhe eksporteve te mallrave, objekt i veprimtarise se shoqerise, qe hyjne ne Shqiperi, prekin kufirin e saj shteteror ose nuk prekin fare ate.*
- *Operacione tregetare ne komisioneri.*
- *Veprimtri industriale me materiale te porositesit.*
- *Prodhim e tregetim te materialeve te ndryshme qe nevoiten per ndertimin dhe kopletimin e objekteve ndertimore.*
- *Si dhe çdo veprimtari tjeter, qe veçmas ose sebashku me ato te permendura me siper do te konsiderohet e pershtatshme dhe me leverdi per rritjen e zhvillimin e shoqerise tregetare.*

Neni 3



Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.

Neni 4

Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: ne Rruga Pjeter Bogdani, Godina 18, Hyrja 1, Ap.1
Tirane, Nr.Pasurise 2/150+1-1, Zona kadastrale 8270. Ajo mund te transferohet ne çfaredo vendi tjeter brenda qytetit te Tiranes ose ne ndonje qytet tjeter te Republikes se Shqiperise me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

Kreu II KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1,000 Leke. Pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise eshte si me meposhtme:

- 1. Smerald Bozaxhiu :** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme 500 leke qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
- 2. Dorian Boja:** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme 500 leke qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimet e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.


Ne te gjithe rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e nje kapitali te nje shoqerie me perjigjesi te kufizuar e te drejta qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributet ne kapitalin e shoqerise.
- b) shitblerjes.



- c) trashegimise.
- ç) dhurimit.
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nepermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne kete statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organ Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gje gjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:


- a) peraktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) ndryshimet e statutit.
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) emerimin e shkarkimin e likujdatoreve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) peraktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare dhe te administrimit, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) perfaqsimin e shoqerise ne gjykatet dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaket mund te perfaqesothen ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqsues i ortakeve ne asamblen e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9 Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme



Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrim ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrim apo mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij nenit, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavarsisht parregullsise.

Neni 10 Kuorumi

Ne rastin e marjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtare dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e mumrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo ne menyre elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e per gjitheshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjitheshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregetare te shoqerise.
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- c) emerimin e shkarkimiv e likuidatorve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- c) percaktimin e shperblimeve.
- d) mbikqyrjen e zbatimit te pilitikave tregetare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedurat e tjera ndaj administratoreve.
- f) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Perjashtim nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjitheshme merr vendim per:

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Ahmet Bozha".

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Bajram Ceku".

- a)vleresimin e veprimtarise se tij.
- b)shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- c)ngritjen e nje padje ndaj tij nga shoqeria.
- ç)dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar , i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 **Administrimi**

Asambleja e pergjitheshme emeron nje ose me shume persona fizike si dhe administrator te shoqerise afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

Administratorret e nje shoqerie tregetare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administrator te nje shoqeri te kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emerin i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

Administrator i shoqerise emerohet z.Smerald Bozaxhiu, ltl. 12/03/1989, lindur dhe banues ne Tirane,Shqiperi,ne adresen Rruga "Alin Demi" Godine Private prane pallatit nr.6, me nr.pasaporte BD2766030 dhe ne nr.personal I90312062G.


Neni 14 **Kompetencat e administratoreve**

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjithe veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politika tregetare, te vendosura nga asambleja e pergjitheshme.
- b) perfaqesoje shoqerine tregetare.
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- ç) perqatisse dhe nenshkuar bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjitheshme per miratim.
- d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e cuhur per trethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- dh) kryeje rregjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Rregjistrimit.
- e) raportoje perpara asamblese se pergjitheshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimtarive te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregetare.
- ë) kryeje detyra te tjera te peraktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjitheshme ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.



-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kene nje vlore me te larte se 5% te aseteve te shoquerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda dy viteve te parapas rregjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5% te aseteve te shoquerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e per gjitheshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e per gjitheshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontaktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoquerise.

Pasojet e marredhenieve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per tje perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet perkatese.

Perceq sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjitheshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoquerise ne teresi , duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoquerise ne mjesi.

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.

c) te vleresoje me per gjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim.

c) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoquerise.

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjet ndaj shoquerise per cdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te aresyeshme me qellimet e shoquerise tregetare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoquerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te tregullt e sipas standardeve te kerkuara.

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoquerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te veçante por pa u kufizuar me to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare" kryen veprimet e meposhtme:

- a)u kthen ortakeve kontributet.
- b)u paguan ortakeve interesa apo dividend.
- c)u shperndan aktivet shoqerise.
- c)lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregetare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
- d)jep kredi.

Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme. Asnjeh vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV **VITI FINANCIAR –EKSPERTET**

Neni 16 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhator. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17 **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate te lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.


Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financier vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqise e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V **PRISHJA – RIORGANIZIMI MI I SHOQERISE**

Neni 18 **Prishja dhe likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuari ne themelin e saj.



- b)me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit.
- c)nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet, dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- d)me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likujdim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje lukujdues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi – ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashokohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtare dhe shoperi tregtare", Kodi Civil dhe çfardo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21


Mosmarreveshjet


Per mosmarreveshje qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si pe çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET E SHOQERISE " MORGAN & CHARLOTTE" sh.p.k.

Smerald Bozaxhiu

Dorian Boja


Smerald Bozaxhiu
Albi Bozaxhiu


Dorian Boja
BL

Shoqeria "MORGAN & CHARLOTTE" sh.p.k

**VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

Sot me date 26.02.2019 ne seline e shoqerise "MORGAN & CHARLOTTE" sh.p.k u mblohdh Asambleja e Ortakeve te shoqerise me pjesmarjen e zoteruesve te 100% te kapitalit.

- Smerald Bozaxhiu Zoterues i 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise
- Dorian Boja Zoterues i 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise

me rend dite :

- Miratimin e krijimit te shoqerise me perjegjesi te kufizuar me emrin "MORGAN & CHARLOTTE".
- Miratimin e statutit per krijimin e shoqerise hartuar ne dt.26/02/2019.

Ne perfundim te mbledhjes, Asambleja e Ortakeve te shoqerise duke pranuar dhe vleresuar bashkepunimin e ortakeve te saj ne unanimitet te plote :

VENDOSI

- Miratimin e krijimit te shoqerise me perjegjesi te kufizuar me emrin ""MORGAN & CHARLOTTE".
- Miratimin e statutit per krijimin e shoqerise hartuar ne dt.26/02/2019

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE

Smerald Bozaxhiu

Smerald Bozaxhiu
All. Bozaxhiu

Dorian Boja

Dorian Boja
J.B.